

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "HART SHPK"

Ne kete statut

"Ligji" eshte Ligji Nr 9901, dt. 14.04.2008 "Per
Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1: **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me 14.02.2025 themeluesi, ka krijuar njeshoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "HART SHPK"

- 1) Themeluesi i shoqerise eshte: Elena Hoxha, shtetas Shqiptar identifikuar me ane te kartes se identitetit me numer J151200430 i datelindjes 20.01.1991, lindur ne Ostren dhe banues ne Tirane; madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2: **Objekti**

- 1) Shoqeria do te kryejte aktivitetin e meposhtem:
Import-Export artikuj ushqimore, industriale etj

Neni 3: **Kohezgjatja.**

- 1) Kohezgjatja e shoqerise eshtee pacaktuar.

Neni 4: **Selia**

- 1) Shoqeria e ka seline ne TIRANE. Farke. Farke e Vogel Njesia Bashkiake nr.2, Rruga e Helikopterave, ndertesa 1 kateshe nr 20
- 2) Me vendim te organit administrativ, shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.

KREU II KAPITALI

Neni 5 **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100,000 (njqind mije) Leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1.Ortaku themelues Elena Hoxha zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (njqind mije) Leke, qe perben 100 % te kap akti themeltar te shoqerise.

Pronari perfitues Elena Hoxha eshte zoterues i 100%te kapitalit themeltar te shoqerise.

- 2) Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Elena Hoxha 

Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- 1) Kapitali i shoqerise mund le zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.
- 2) Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- 3) Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.
- 4) Nete gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve le kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit te shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mundet te fitohen apo kalohen nepermjet
 - a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashegimise;
 - d) dhurimit;
 - e) cdo menyre tjeter le parashikuar me ligj.
- 2) Pjeset e kapitalit themeltar Jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut..
- 3) Pjeset e kapitalit themellar Jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

- 1) Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 2) Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton do ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel le autorizuar;
 - e) percaktimin e shperblimeve per personate permendur ne shkronjat "c" dhe " " le kesaj pike;
 - f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g) miralimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) pjerpjestimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administraloreve;
 - j) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
- 5) Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
- 6) Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje le asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite

Faqe 2 e 6

Statut dhe akti I themelimi
I shoqerise me pergjegjesi le kufizuar

HART SHPK

Elena Hoxha 

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 1) Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese ape me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 2) Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per le marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

- 1) Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
- 2) Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose perceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 le ligjit " Per Tregtare dhe Shoqerile Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zotrojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, ape mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- 3) Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me von se 30 dite, me te njeitin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- 2) Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. per ceshtje le tjerasi:
 - a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
 - b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve
 - e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykale dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale le mbledhjeve le asamblese;
- 3) cdo ndryshim ne statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

- 1) Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme rreth vendim per:
 - a) vleresimin e veprimtarise se tij;
 - b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
 - d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
- 2) Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njeitin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Faqe 3 e 6

Statut dhe akt I themelimi
I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

HART SHPK

Elena Hoxha 

Neni 13

Administrimi

- 1) Administratori i shoqërise emërohet Elena Hoxha shtetas Shqiptar identifikuar me anë të kartës identiteti me numër J151200430 i datëlindjes 20.01.1991. lindur në Tiranë dhe banues në, me afat emerimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emerimit.14/02/2025 deri 14/02/2030.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërise. Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejtë riperteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 4) çdo emerim i bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërise, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullit të dokumenteve dhe të të librave kontabel të shoqërise;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërise;
kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhenat e detyrueshme të shoqërise, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit
 - g) raportojnë përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me më të rëndësishme të vecante për veprimtarinë e shoqërise tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratorët janë të detyruar të thellasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërise nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërise, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërise, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme e emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërise ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërise.
- 2) Pasojat e rënësishme le pa miratuar nga asambleja që i sjellin dem shoqërise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshëmshënkërkimes, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

Faqe 4 e 6

Statut dhe akti I themelimi
I shoqërise me përgjegjësi të kufizuar

HART SHPK

Elena Hoxha 

- a) le kryeje detyrat e tij le percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
 - b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve le percaktuara ne keto dispozita;
 - c) le vleresoj me pergjegjesi i ceshtjet, per te cilat merret vendim;
 - d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
 - e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
- 4) Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshle kryer ne mirebesim.
- 5) Nese administratori vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 le ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personal e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime le parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve le kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ala pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
- 6) Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demete shkaktuara, nese, ne kundershtrim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:
- a) u kthen ortakeve kontributet;
 - b) u paguan ortakeve interesa apodividente;
 - c) u shperndan aktivet shoqerise;
 - d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze le gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do le kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Pervet padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.
- 8) Paditesit kane te drejte le ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plate te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

- 1) Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit le shoqerise ne Qendren Kombetare le Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

- 1) Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel le veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjitha vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'jua paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREUV PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Elena Hoxha 

Neni 18

Prishja dhe Likuidimi

- 1) Shperndarje ose prishja e shoqerise mund le behen ne c do kohe:
 - a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave te falimentit;
 - d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me ligjin.
 - e) me vendim te gjykates;
- 2) Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke cakluar 1 apo disa likuidalore dhe shenuar ne do dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidalorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- 3) Prishja e shoqerive treglare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguesve, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.
- 5) Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, do person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise, bashkimi, ndarja

- 1) Shoqeria mund le ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme le Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX le Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- 1) Shoqeria do te zhvilloje aktivitele ne te cilat ne perputhje te plote me kele statul dhe dispozitat e te legjislacioneve shqiptar.
- 2) Per sa nuk parashikohet ne kele statul, do te zbalohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfare do ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarveshjet

- 1) Tegjitha mosmarveshjet qe mund le lindin do te zgjidhen me mirekuplim, ne te kundert do te zgjidhen nepermjet organeve te posacme te njohura nga ligji.

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR HART
SHPK

Elena Hoxha 